VENDIM
Nr. 97, datë 14.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 419, DATË 25.6.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKL-JA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në titull dhe kudo në vendim, emërtimi "Qendra Kombëtare e Licencimit" zëvendësohet me "Qendra Kombëtare e Biznesit" dhe shkurtimi "QKL" zëvendësohet me "QKB".

b) Në kreun II bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Shkronja "ç", e pikës 1, shfuqizohet;

ii) Pas pikës 1, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1. Dokumentet "Kopje të vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për VNM-në" do të kërkohen gjatë këtij procesi, por këto dokumente do të gjenerohen nga vetë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë, të përfshira në këtë proces.".

c) Në kreun III bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Shkronja "ç", e pikës 1, shfuqizohet;

ii) Pas pikës 1, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1. Dokumentet "Kopje të vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për VNM-në" do të kërkohen gjatë këtij procesi, por këto dokumente do të gjenerohen nga vetë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë, të përfshira në këtë proces.".

ç) Në kreun VI bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Shkronjat "b" e "dh", të pikës 2, shfuqizohen.

ii) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1. Dokumenti "Përmbledhja joteknike e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së" do të kërkohet gjatë këtij procesi, por ky dokument do të gjenerohet nga vetë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë, të përfshira në këtë proces.".

d) Shkronjat "b" e "c", të pikës 2, të kreut VII, shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama